



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E NOVOBËRDËS - OPŠTINA NOVO BRDO
DALËSE - IZLAZNA

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

Nr/Br

01 / 1263

19.12.2025

NOVOBËRDË - NOVO BRDO



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Zt. Stefan Denic

RAPORT I PUNËS SË KUVENDIT PËR PUNËN E KUVENDIT PËR VITIN KALENDARIK 2025

Janar 2026

Të respektuar/a

Anëtarë/e të Kuvendit Komunal të Novobërdës.

Ju drejtohem si Kryesus i Kuvendit të ju raportoj për punën një-vjeçare të Kuvendit Komunal të Novobërdës, duke i përmbledhur rezultatet në çdo fushë, kështu edhe Kryesusi i Kuvendit ka obligim që për punën vetë dhe të Kuvendit ti njoftoj ata me të cilët së bashku punuam për të përmisuar kualitetin e punës, si dhe të gjithë atyre që janë të lidhur me Kuvendin pa të cilët nuk mundet të punojmë dhe realizoj qëllimet e tona: Kryetarin, Drejtorët, Ministrin kompetente e në fund edhe ata që janë më të rëndësishmit e na kanë dhënë besimin, që t'i prezentojmë në këtë organ, e ata janë qytetarët e Komunës sonë.

Gjithashtu kam knaqësinë që jamë në krye të një Kuvendi multietnik, për të cilën mundë lirishtë të themë që paraqet një shembull të mire të bashkpunimit në mesë të Këshilltarëve të Komuniteteve të ndryshme ku në planin e parë është bashkëpunimi në mesë të anëtarëve të komuniteteve të ndryshme, dhe kanë për qëllim realizimin e kushteve më të mira të jetës për qytetarët .

Siç është e ditur Kuvendi Komunal mbështetet në aktet juridike, duke filluar nga Ligji për Vetqeverisjen Lokale, si aktin më të lartë e përmes Statutit si aktin më të rëndësishëm të Komunes, Rregullores e punës së Kuvendit dhe akteve tjera që i aprovon Komuna. Në këtë drejtim në bazë të nenit 43.2, Ligjit për Vetqeverisje Lokale, si dhe nenit 43.5 të statutit, Kuvendi i Komunës është e obliguar t'i mbajë dhjetë mbledhje të rregullta gjatë vitit, edhe atë Pesë në pjesën e parë të vitit dhe Pesë në pjesën e dytë. Me knaqësi mundë të konstatoj se kemi vepruar në bazë të nenit 43.2 LVL, si dhe nenit 43.5 të Statutit në kuptimin e përmbajtjes së afateve për mbajtjen e mbledhjeve.

Kuvendi Komunal ka mbajtur 8 (tetë) mbledhje të rregullta (Janar -Shtator ku në muajin Tetor kanë qenë zgjedhjet Lokale) dhe dy degjime publike me qytetarët e komunes ku në keto degjime publike ka pasur nje numer të konsiderueshem të qytetarve .

Pas çertifikimit të zgjedhjeve janë mbajtur edhe 2 (dy) mbledhje, 1 (nje) mbledhja inagruese dhe 1 (një) mbledhje për zgjedhjen e Kryesuesit dhe zv.kryesuesit të Kuvendit.

Gjatë ketyre tetë mbledhjeve kemi diskutuar shumë tema të ndryshme ku temat që mëse shumti ka pasur diskutime nga ana e anëtarëve kanë qenë temat që janë diskutuar për Rrugën: Prekoc- Strazh - Stanishor, temë tjetër e diskutimit kanë qenë edhe Gurthyesit që operojnë në teritorin tonë ku ishë Kryesusja se bashku me Kryetarin e Komunes dhe në bashkpunim me Agjensionin për Minjera dhe Minerale kemi pasur takim të përbashket me kompanit dhe qytetarët e fshatrave si: Strazh, Stanishor, Koretisht.

Temë tjetër që duhet të përmendet është edhe Emrimi i Rrugëve në teritorin e Novobërdës, ku pas një pune shumë të lodhshme dhe me shumë sfida në muajin Korrik në bazë të Komisionit për Emrimin e Rrugëve, Kuvendi ka pruar vendimin për Emrimin e Rrugëve dhe ka miratuar, Listen për Emrimin e Rrugëve që ju është ofruar nga Komisioni për Emrimin e Rrugëve.

Të gjitha mbledhjet janë mbajtur në bazë të planit vjetor të punës dhe anëtarët janë njoftuar me kohë 7 ditë para mbledhjes siq është e cekur në nenin 43.3, të LVL.

Gjatë ketyre 8 (tetë) mbledhjet e rregullta të mbajtura gjatë vitit 2025 janë aprovuar:

24 Vendime, dhe të gjitha janë verifikuar nga ana e Ministrisë kompetente për Vetqeverisje Lokale dhe 2 vendime pas konstituimit të Kuvendit të ri.

Pasë verifikimit të të gjitha Vendimeve nga Ministrit e linjes prej 24 vendimeve, vetem 2 Vendime jemi detyruar që ti Anulojm për arsye se vendimet nuk kanë qenë në harmoni me ligjislacionin në Fuqi. e ato vendime kanë qenë:

Vendimi për ndarjen e nje parcele për ndertimin e stacionit të policis,ku në arsyetimin e Ministris gjegjëse thuhej se kerkesa e drejtuar duhet të ishte drejtuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policis e jo nga Komandanti i Stacionit të Policis në Novoberd,pas shumë konsultimeve me komandantin e Policis në Novoberdë qe ta siguron kerkesen nga drejtori i pergjithshem i policis dhe ta dergojm në Ministri ata nuk kanë siguruar kërkesen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policis, dhe ne jemi detyruar që ti respektojm afatet kohore prej 30 ditesh dhe në fund kemi anuluar Vendimin në Fjalë.

Ndersa Vendimi tjetër ka qenë për: Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Regjionin e Gjilanit.

ku pasë dergimit të vendimit dhe Planin Nderkomunal për Menaxhimin të Mbeturinave në Ministrin e Linjes ata kanë konstatuar se Plani nuk është në harmoni me ligjet në fuqi dhe ne jemi detyruar që ta respektojm afatet ligjore prej 30 ditve. Për ta permirsuar dhe harmonizuar me ligjet në fuqi, Drejtoria e Shërbimeve Publike nuk ka punuar asëgjë në këtë drejtim ne si kuvend jemi detyruat që ta anulojm vendimin.

Kuvendi përveq mbledhjeve të rregullta të kuvendit kemi mbajtur edhe mbledhje të rregullta të Komitetit për Politik dhe Financa ku për këtë viti i kemi mbajtu 8 (tetë) mbledhje që do të thotë se para çdo mbledhje të Kuvendit kemi diskutuar njëher pikat në KPF-ë.

Po ashtu edhe komiteti për komunitete ka mbajtur 8 (tetë) mbledhje të rregullta ku ka diskutuar tema të ndryshme ,ku disa prej pikave të rendit të dites janë propozuar nga ky komitet që të shkojnë për diskutim edhe në KPF dhe Kuvend, për qka edhe jemi falenderues.

Të nderuar Antarë të Kuvendit në fundë të këti raporti deshiroj të falenderoj edhe Administraten e Kuvendit të cilet janë një grup fantastik që punojnë pa u lodhur të gjitha keto dokumente që vinë te ne si anëtar të kuvendit pregaditen nga Administrata e kuvendit po ashtu ju falenderoj edhe juve anëtar të Kuvendit për bashkpunimin dhe kontributin e juaj në punën e Kuvendit. Çdo propozim u juaji është i mirëseardhur, shpresoj që në këtë vit të kemi edhe më shumë bashkpunim me Këshillin Egzekutiv dhe me angazhimin tone, me sjellje të mirfilltë mundemi të realizojmë rezultate më të mira në Kuvendë ku e gjithë kjo do të reflektohet në përmisimin e shërbimeve për të gjithë qytetarët, dhe shërbimet tjera si dhe ngritja e nivelit të infrastruktures Komunale.



Kryesusi i Kuvendit të Komunës së
Novobërdës

S. Denic

Stefan Denic